



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 788 Prot.

Tiranë, më 14.04.2026

**VENDIM QARKULLUES**

Nr. 27 Datë 13.04.2026

**“PËR  
NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR.4 DATË 13.01.2026 TË BORDIT TË  
ADMINISTRIMIT DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËRFUNDIMTARE  
TË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT MASTER I SHKENCAVE NË "SHKENCA  
REHABILITUESE TË PROFESIONEVE TË SHËNDETIT", ME DIPLOMË TË  
DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS,  
FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË REHABILITIMIT DHE UNIVERSITETIT  
"MAGNA GRAECIA" TË KATANXAROS NË ITALI”**

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, në nenin 7, 43, 73 të Statutit të UST-së, në Rregulloren e UST-së neni 24, në Vendimin nr.58, datë 13.04.2026 të Rektoratit, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 55 datë 13.04.2026, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 13.04.2026

**V E N D O S I :**

1. Ndryshimin e Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 4 datë 13.01.2026, dhe miratimin e marrëveshjes përfundimtare të programit të përbashkët Master i Shkencave në "Shkenca Rehabilituese të Profesioneve të Shëndetit" me Universitetin "Magna Graecia të Katanaxaros në Itali, (bashkëlidhur).
2. Nisjen e procedurave për aplikim për hapjen e programit të përbashkët Master i Shkencav në "Shkenca Rehabilituese të Profesioneve të Shëndetit", me diplomë të dyfishtë midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit dhe Universitetit "Magna Graecia" të Katanaxaros, Itali".
3. Miratimin e pagesave për profesoratin e ftuar për mbulimin e shpenzimeve të transportit, fjetjes, dietës ditore si dhe pagesën për orë mësimdhënieje, sipas akteve rregullore dhe marrëveshjes së miratuar.

4. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim FSHR-së, Administratorit të UST-së, Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit si dhe Drejtorisë së Zhvillimit Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore .
  
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Artur ÇOBANI**

